


O.N.E.

Office de la Naissance et de l'Enfance
Zyra për Lindjet dhe Fëmijë
(Traduction en Albanais)

Pritja e një fëmije, ti ndihmohet të rritet,
qfar aventure e bukur...

O.N.E./Z.L.F. Mundet, nëse ju dëshironi,
të ju përkrahë dhe të ju shoqërojë në
rolin tuaj të prindit.



Ju jeni në pritje të foshnjës...

Një aventurë nëntëmujore fillon...

Konsultimet para lindjes

Këto konsultime janë vende të hapura për të gjithë prindërit e ardhëshëm, të cilat gjinden në një spital ose në një lagje.

Ju do të pranoheni nga ana e një Gjinekologu dhe një Punëtorit-Mediko-Social (T.M.S./P.M.S.). Ky person kryesisht është femër, asistente sociale ose infermiere.

Ata do të mbikqyrin shtjellimin e shtazanisë, do të verifikojnë zhvillimin e foshnjës dhe do të kujdesen poashtu për shëndetin e mirë të nënës së ardhëshme.

Mjeku do të realizojë një seri të analizave (analizën e gjakut, ekografi, ...). T.M.S./P.M.S. do të ketë kënaqësi të ju përgjigjet në pyetjet tuaja, të ju japë të gjitha informatat të cilat ju dëshironi ti keni mbi shtatzaninë, shtjellimin e lindjes, të ushqyerit e gruas shtatzane, ... Ai mundet poashtu të ju vizitojë në shtëpin tuaj për të diskutuar me juve rreth ardhjes së foshnje tuaj ose të ju udhëzojë për ecuritë administrative (primi i lindjes, ...).

Me rastin e vizitës tuaj të parë, juve do të ju ipet « Libreza e nënës », e cila paraqet përmbledhje e të dhënave të shtazanisë. Ruajeni me kujdes! Ajo do të shërbejë si ndërlidhje mes të gjithë profesionelve shëndetësorë të cilët do të ju shoqërojnë përgjatë këtyre 9 muajve.



Z.L.F.-ja (O.N.E.), është poashtu...

– **Pranimi (strehimi) i fëmijëve gjatë kohës së lirë**

Z.L.F.-ja kujdeset poashtu për kualitetin e pranimit të fëmijëve jashtë orëve të shkollës (pranimi ekstra-shkollorë, shkolla e detyrave, qendra të pushimit, ...).

– **Ekipeve SOS Fëmijët**

Në rast të vështërsive, profesionelët e 18 ekipeve SOS Fëmijët do të ju ndëgjojnë dhe do të ju ndihmojnë.

– **Informatat për prindërit**

Z.L.F.-ja (O.N.E.) është aty për tu përgjigjur pyetjeve tuaja. Ajo boton broshura edukative për shëndetin si dhe fletushka të ilustruara relative me ushqimin, gjumin, zhvillimin e fëmijut, ... Animacione rreth këtyre temave organizohen poashtu.

« *Air de familles* » (« Ambient familjarë ») është takim për familjet në valët e RTBF-it (La Une dhe La Deux – dy kanalet televizive). Këshilla praktike ipen aty nga ana e specialistëve të ardhur nga Z.L.F.-ja (O.N.E.) ose në kontakt të shpeshtë me të.

– **Z.L.F. (O.N.E.) - Adoptimi**



Ky shërbim shoqëron prindërit biologjik (nga lindja), të adaptuarit dhe adaptuesit dhe realizon adaptime të fëmijëve të lindur ose që banojnë pranë Komunitetit francez.

– Ti dini të gjitha mbi Z.L.F.-në (O.N.E.-në) ?

Vizitoheni sitin www.one.be

ose

telefononi në numrin **08/542.12.11**



Foshnjore, personat që kujdesen për fëmijë...? Qfarë lloji i kujdesit të zgjidhet?

Foshnja ende nuk është lindur, mirëpo që tani, është e preferuar të mendohet që nga muaji i 4-të i shtatzanisë.

Z.L.F.-ja bën gjith q'është e mundëshme për të ju mundësuar të zgjidhni llojin e kujdesit i cili përgjigjet dëshirës tuaj.

A e dini se cilado strukturë e kujdesit të fëmijëve, e cila organizon në mënyrë të rregullt kujdesin ndaj fëmijëve prej 0 deri 6 vite, duhet të bëjë paraprakisht deklaratën pranë Zyrës dhe duhet marë autorizimin? Ajo duhet poashtu të jet konform Kodit të kualitetit.

Egzistojnë tipe të ndryshme të kujdesit të fëmijëve :


– në kolektivitet :

Qerdhe, foshnjore, shtëpia komunale e fëmijërisë, shtëpia e fëmijëve, halt-garderie, farandoline, ...

– në shtëpi :

Kujdestar(e) i/e konvencionuar me një shërbim ose kujdestar(e) autonome.

Konsultojeni broshurën : Qfarë strukture të kujdesit të fëmijëve të zgjidhet për fëmijun tonë?



Foshnja juaj sapo është lindur... Pranoni urimet tona!





– Në maternitetet

Në të shumtën e materniteteve, një P.M.S. (T.M.S.) nga Z.L.F.-ja (O.N.E.) do të ju prezantojë të gjitha shërbimet që ofron Z.L.F.-ja pas lindjes së fëmijut tuaj.

– Konsultimet për fëmijë

Konsultimet për fëmijë janë falas dhe të hapura për të gjithë prindërit dhe fëmijët e moshë 0 deri 6 vite. Ata kanë për qëllim të verifikojnë se a është fëmiju juaj mirë me shëndet. Një ekip, i përbërë nga një mjek, një P.M.S. dhe prej vullnetarëve për të realizuar, me takim, një sërë analizash mjekësore (vaksinime, testi i të pamurit, të të dëgjuarit, ...). Ata do të ju përgjigjen poashtu në të gjitha pyetjet tuaja. Ata prapa mund të ju ndihmojnë në rolin tuaj të prindit.

Aktivitetet shumënumërt organizohen ndër të tjera në kuadër të këtyre konsultimeve (konferenca, këndi i lojës, këndi i leximit, vende të bisedës, ...). Këto animacione janë aq më shumë rast për të njohur persona tjerë dhe për të ndarë së bashku përvojat tuaja. Ndër të tjera, nëse ju dëshironi, PMS-i mund të ju vizitojë në shtëpi ose të ju pranojë gjatë kujdestarive. Në disa regjione, ekzistojnë autobusët sanitarë. Janë konsultime « mobile » të cilat ofrojnë të njëjtin shërbim si konsultacionet fikse.



Adresa të dobishme ...

Ju kërkoni një konsultacion?

Një vend për kujdesjen e fëmijëve?

Zyra për Lindjet dhe Fëmijë
është shërbim publik i Komunitetit francez të Belgjikës.
Shërbimet e saja janë të vendosura pran juve,
të hapura për të gjithë në Valoni dhe Bruksel.



– Administrata qendrore e ZLF-së

Chausée de Charleroi 95
1060 Bruksel
Tel. : 02/542.12.11 – Fax : 02/542.12.51
E-mail : info@one.be



– Komitetet nënregionale :

Në Brabant Valoni
Home Reine Astrid
Avenue de la Reine 1
1310 LA HULPE
Tel. : 02/656.08.90 – Fax : 02/656.08.89
E-mail : vrancken.sabine@one.be

Në Liège
Boulevard Emile de Laveleye 40
4020 LIEGE
Tel. : 04/344.94.94 – Fax : 04/344.94.94
E-mail : patrick.joris@ONE.be

Në Bruksel
Rue de l'Hôpital 31 Bte 1 (kati i 11-të)
1000 BRUKSE
Tel. : 02/511.47.51 – Fax : 02/511.51.26
E-mail : violette.huart@one.be

Në Luksemburg
Rue Fleurie 2 – Bte 8
6800 LIBRAMONT-CHEVIGNY
Tel. : 061/23.99.60 – Fax : 061/22.49.25
E-mail : michele.bouche@one.be

Në Hainaut
Domaine du Bois d'Anchin
Route d'Erbisoeul 5
7011 GHLIN
Tel. : 065/39.96.60 – Fax : 065/34.07.36
E-mail : marianne.dehon@one.be

Në Namur
Rue de Coquelet 13
5000 NAMUR
Tel. : 081/72.36.00 – Fax : 081/72.36.08
E-mail : carole.picheret@one.be

– Biblioteka e ZLF-së



Espace 27 septembre
Boulevard Léopold II 44
1080 BRUKSEL
Tel. : 02/413.22.13
E-mail : veronique.marchal@cfwb.be

Me përkrahjen e Komunitetit francez
Valoni-Bruksel dhe të Lotarisë nacionale